



THE GOVERNMENT  
OF THE GRAND DUCHY OF LUXEMBOURG



## Aplikim për praktikë pune dhe trajnime

Organizata Peer Educators Network (PEN) ofron mundësi të shkëlqyeshme për të gjithë të rinjtë dhe të rejtat e moshës 18 – 25 vjeçare për aftësimin profesional, krijimin e shkathtësive të reja komunikuese, zhvillimin e mendimit kritik, aftësimin në përpilimin e projekteve dhe mundësinë për të ndërmarrë iniciative inovative në komunat përkatëse.

Të gjitha këto risi vijnë si pjesë e projektit Social Act që synon t'i rikthej në shoqëri aktive të gjithë ata që kufizohen nga mungesa e përvojës së punës, edukimi jo i kënaqshëm, kushtet ekonomike-sociale dhe diskriminimet për shkak të përkatësive shoqërore të ndryshme.

Përveç aftësimin individual, me angazhimin tuaj ju do të ndikoni drejtpërdrejtë në komunitetin tuaj duke i identifikuar dhe adresuar problemet kryesore rreth gjithëpërfshirjes sociale. Iniciativat e juaja do të krijojnë mundësi edhe për të rinjtë e tjerë me të cilët së bashku do të nisni ndryshimin në komunën tuaj.

*Cikli i parë i projektit do t'i përfshijë këto komuna: **Ferizajin, Fushë Kosovën, Lipjanin dhe Mitrovicën.***

Pjesëmarrësit e suksesshëm do të angazhohen përgjatë periudhës **Prill deri Shtator 2018.**

Aplikimi bëhet online në google formën të cilën mund ta gjeni në këtë link: <http://bit.ly/2pdquRm> .

Me këtë rast na nevojitet vetëm forma e aplikimit pa CV apo letër motivuese.


**Afati i fundit për aplikim është me datën 22.03.2018, e enjte, deri në orën 16:00.**

Për më shumë informata ju lutem na kontaktoni në [info@ngo-pen.com](mailto:info@ngo-pen.com) apo në numrin e telefonit +381 38 223 942.

Ky grant është financuar nga projekti 'Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë', financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



SOCIAL ACT



GROW



CONNECT



IMPACT